

LAURA FREUDENTHALER

**MBRETËRESHA HESHT**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integrimit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zvicëran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

traduki™

LAURA FREUDENTHALER

MBRETËRESHA HESHT

roman

Përktheu nga origjinali gjermanisht  
Admira Poçi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Laura Freudenthaler  
Titulli në origjinal: Die Königin schweigt  
Botoi në gjermanisht: Literaturverlag Droschl GmbH.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Anrila Spahija  
Korrektore letrare: Majlinda Bani  
Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj  
Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-69-7

© e përkthimit TRADUKI  
© 2018, Literaturverlag Droschl GmbH. Botuar sipas marrëveshjes me  
Nabu International Literary Agency, Firenze.  
© në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA  
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: botimet.toena@gmail.com  
toena.porosionline@gmail.com  
www.toena.al

Paraardhëseve të mia



NDONJËHERË AJO BËNTE KAFENË dhe, ndërsa uji kalonte nëpër filtër, shkonte te dera e shtëpisë, ashtu si kishte vepruar më parë çdo mëngjes për të marrë gazetën. Në kutinë postare kishte gazeta të shumë ditëve dhe, kur Fani i mori, një kafshëz e vogël ra mbi shkallët e gurta. Një gërshërëz. Kur fëmija kishte qenë e vogël, Fanit i ishte dashur ta tregonte prapë e prapë historinë, se si njëherë, asokohe në fshat, tek ajo kishte ardhur një druvar, sepse i dhembte shumë veshi. Gjatë tregimit fëmija kishte ngritur duart drejt veshëve dhe kishte mbyllur sytë, pasi nuk donte ta shihte atë që po përfytyronte. Por kurrë nuk i mbyllte veshët, përkundrazi e dëgjonte historinë deri në fund dhe lëshonte një tingull midis llahtarës dhe magjepsjes, kur Fani tregonte, se si i kishte tërhequr druvarit nga veshi një gërshërëz të madhe me piskatore. Fani e largoi me këmbë kafshëzën nga cepi i shkallëve. Kur mbesa ishte pak më e rritur, thoshte me zë qortues, se nuk ishte aspak e vërtetë, që gërshërëzat të futen në vesh dhe që Fani tregonte histori tmerri. Fani hodhi sytë në pjesën e përparme të kopshtit të saj. Ferrat me gonxhet e vogla të trëndafilut tashmë prej kohësh nuk ishin më aty. Bredhi lartohej si përherë në qoshen e majtë të kopshtit dhe tërhiqte shumë korba, që rrinin për kohë të gjatë mbi degët e gjera. Ndonjëherë Fani shkonte deri te porta e kopshtit dhe shihte rrugën jashtë. Kur shihte ndonjë fqinj, i cili e vinte re dhe ngrinte dorën për ta përshëndetur, ndoshta donte të vinte në drejtim të

saj, Fani kthehej brenda në shtëpi. Ajo hidhte kafënë në një filxhan. Kur qumështi ishte thartuar, shtonte pak ujë. Ulej në tryezën e ngrënies, i hidhte kafesë disa lugë sheqer dhe e trazonte. Në njërën prej gazetave kërkonte fjalëkryqin dhe merrte në dorë një stilolaps. Ndoshta syzet i kishte lënë te parvazi i dritares në dhomën e ndenjjes. Përpiqej të kuptonte të dhënat që sidoqoftë përsëriteshin prej dekadash dhe shënonte disa germa nëpër kutiza. Mbesa thoshte, se germat e Fanit dukeshin si këmbët e pulës. Fani shihte nga dritarja e kuzhinës. Më parë, kur shquante postierin të kalonte atypari, ajo shkonte te dera e shtëpisë, merrte postën dhe këmbente ndonjë fjalë me të. Tani postieri nuk ishte më i njëjti dhe vinte në kohëra të ndryshme. Fani nuk dinte të thoshte me siguri, sa ishte ora, ç' pjesë e ditës ishte. I hodhi sytë sërish fjalëkryqit. Në kokë i shfaqej një fjalë, por nuk ishte ajo që po kërkonte. Një rrokje e vetme, që Fani nuk e dinte ku e kishte vendin. Por ku ajo rrinte ulur kështu në tryezën e kuzhinës, me një kafe dhe gazetën, mund të ndodhte që ky çast t'i dukej si i njëjtë me atë pak më parë.



MËNGJESEVE AJO NGRIHEJ GJITHNJË E PARA, ndërsa të tjerët flinin ende. Ishte diçka e mistershme të ishe e vetmja që ishte zgjuar nga gjumi. Askush nuk e dinte, se ishe atje. Për një gjysmë ore a një orë të tërë Fani ishte vetëm, pinte kafënë dhe mendonte, se ç'kishte për të bërë atë ditë, pastaj fillonte me ngadalë të kryente punët. Në ditë të mira përjetonte çaste si ato të kahershmet, çaste të shkëputura të kaluara, që vinin në kohët e sotme, pasi ishin përjetuar shumë herë. Por shpesh Fani nuk ngrihej dot nga shtrati për ditë me radhë dhe as nuk e dallonte njërin ditë nga tjetra. Qëndronte shtrirë në shtratin e saj martesor, që kurrë më, për dekada me radhë, nuk e kishte ndarë me dikë, ndërsa nga dritarja dukej se si ditët kalonin. Në pemën e kumbullës kishte disa zogj, ata iknin, kur binte shi, vinin prapë, kur dielli shkëlqente. Ndonjëherë Fanit i dukej, se dëgjonte hapa rreth shtëpisë. Binte zilja e telefonit. Fani përpiqej të krijonte në trupin e saj impulsin që do të mund ta drejtonte atë dhe ta nxirrte nga shtrati. Më kot. E dëgjonte zilen e telefonit, tek binte. Përfytyronte, që Hana dëgjonte me kujdes tingullin në receptorin e telefonit dhe priste që Fani ta ngrinte. Nga koha që kalonte derisa të pushonte telefoni, Fani konstatoje, sa i madh ishte shqetësimi i Hanës, dhe sa i madh probabiliteti që Hana t'i hipte makinës dhe pas tri orësh të hynte te dera e shtëpisë. Kjo kishte ndodhur vetëm njëherë, por qysh atëherë Fani gjithnjë shpresonte, se do të ndodhte përsëri. Zilja e telefonit pushoi. Fani nuk arriti të ngrihej. Ndoshta mund të kishte qenë edhe e mbesa. Ajo

kishte kohë që nuk bëhej e gjallë. Herë pas here vinte ndonjë kartolinë nga jashtë shtetit. Fani ktheu kokën nga jastëku në qoshe. Mbi komodinë ishte një libër me faqe boshe dhe ballinë të verdhë në të artë. Ai i kujtonte të mbesën. Vetëm faqja e parë e librit nuk ishte bosh, mbi të mbesa kishte shkruar: Gjyshe e dashur. E më poshtë shkruhej se ajo i dhuronte Fanit këtë libër për të hedhur kujtimet e saj. Mbesa kishte dashur të fliste me Fanin për kujtimet. Jo përrallat e tua të fshatit, i kishte thënë ajo. Të shkuarën e vërtetë. Fani kishte buzëqeshur. Nuk po e kuptonte, çfarë kërkonte fëmija prej saj. Ende nuk e dinte. Ndoshta fëmija tashmë e kishte kuptuar, që të vdekurit është mirë t'i lësh të prehen, e prandaj ishte zhdukur. Për të mbesën, kishte mundësi që edhe ajo vetë t'i përkiste të vdekurve. Mbesa e kishte pyetur, nëse kishte ruajtur ndonjë fotografi nga fëmijëria e saj. Fotografi, kishte pyetur Fani. Po, kishte thënë mbesa. Ajo ishte e paduruar. Për disa gjëra nuk flitet, thoshte babai. Gjithçka që kishte qenë njëherë, tani ndodhej në këtë shtëpi. Fani dëgjonte zhurma nga qilari, a thua se dikush po punonte në tryezën e punës. Mëngjesi, kur ajo kishte lënë filxhanin e kafesë në tokë, poshtë rrushit të frëngut, i kishte mbetur në mendje si një fotografi. Mënga e verdhë e këmishës së saj në shkurren e rrushit të frëngut, midis të gjelbrës së gjetheve dhe të kuqes së çelët të rrushqeve. Ajo ishte mësuese dhe askush nuk mbante këmishë në fshat përveç saj. Prifti admironte bukurinë e Fanit. Ajo e kthente kokën nga ana tjetër.

FLOKËT E SAJ ISHIN TË BARDHË dhe kështu do të mbeteshin. Të dridhurat nuk do t'i ndaheshin më. Zilja e telefonit ra dhe pushoi sërish. Fani hodhi sytë nga dritarja, hapi sytë e i mbylli, donte të bënte edhe njëherë gjumë të thellë. Dremiti dhe u end nëpër kohë, ishte ulur si një vajzë e vogël përtokë në çiflig atje në lug. Dielli shkëlqente me ngrohtësi dhe nuk frynte erë. Çifligu ishte i mbyllur nga tri anë. Ana e katërt ishte një portë e madhe që qëndronte e hapur. Ishte verë, toka ishte e fortë dhe e thatë, me një shtresë me rërë përsipër. Atje Fani pikturonte valë me gisht. Në stolin te muri i shtëpisë ishte ulur thatanikja plakë e fishkëllente lehtë, tek nxirrte frymën. Fishkëllima shoqëronte lëvizjet e valëve të gishtave të Fanit. Kur fëmija ngrinte sytë lart, shihte kërcinjtë e thatanikes që regëtinin, kur ndonjë mizë i ulej mbi lëkurë. Valë kaltëroshe kalonin edhe nëpër kërcinj. Fani dëgjonte edhe diçka tjetër pas fishkëllimës. Vendosi gishtin me rërë në mjekër dhe vështroi përreth. Një zog klithi dhe pastaj heshti. Zhurma vinte nga ahuri, Fani hapi veshët. Papritur gjithandej dëgjoheshin zhurma që e mbysnin atë të ahurit. Fani dëgjoi goditje, një çokitje prej së largu, hungërima e një kafshe depërtoi dobët deri në çiflig. Nga ndërtesa e ahurit doli një krijesë e madhe. Babai po vinte, përmes çifligut, në drejtim të Fanit. Sa më shumë afrohej, aq më i madh bëhej ai. Ndaloi pranë saj. Fëmija ngriti kokën dhe sytë drejt tij. Babai pohoi me kokë dhe e thirri në emër: Fanushe. Zgjati njërën dorë, si të donte

të kapte kokën e Fanit, ajo i ndjeu gishtat tek preknin ajrin. Një qime u ngatërrua në dorën e ashpër, një tërheqje dhe një dhembje e vogël, kur u këput nga koka e Fanit. Babai tundi kokën edhe njëherë dhe vazhdoi rrugën drejt portës. Fani donte t'i shkonte nga pas. Sapo ishte ngritur dhe kishte bërë disa hapa, kur e pa të zhdukej nga porta dhe nga pas dikush e zuri prej krahësh dhe e ngriti. Thatanikja plakë e vendosi Fanin sërish në vendin e saj. Fëmija kundërshtoi dhe u përpoq të kafshonte dorën që po e mbante. Fanit nuk i pëlqente shërbyesja, e cila kishte për detyrë ta ruante.

MË VONË AJO DO TË KUPTONTE, se në fshat nuk kishte asnjë fëmijë tjetër, për të cilën kujdesej dikush. Fëmijët e tjerë rrinin bashkë në grup, në pyll e nëpër çifligje, dhe kërkonin ndonjë të rritur, vetëm nëse njëri syresh vritej. Më vonë Fani dëgjoi të thoshin, se në të gjithë zonën kishte vetëm dy kujdestare fëmijësh, njëra për fëmijët e pasanikëve dhe tjetra për Fanushen. Pasanikëve u përkisnin të gjitha tokat e gjithashtu fabrika e sharrës, ku punonin shumë burra. Fani e njihte kështjellën, ku thuhej se banonin zotërinjtë pasanikë, por nuk kishte parë asnjëherë ndonjërin prej tyre, madje as fëmijët. Kohë më vonë mamaja thoshte se shërbyesja plakë, që ata e quanin thatanike, nuk bënte më për asnjë punë e prandaj kujdesej për Fanin në kohën kur të tjerët ishin në fushë. Ndonjëherë koha ishte shumë e gjatë, derisa ktheheshin prindërit dhe i vëllai. Por nuk kishte rëndësi, sa gjatë kishte pritur Fani derisa ata të shfaqeshin te porta, ajo e mbante gojën të mbyllur fort, në mënyrë që gëzimi të mos i dilte jashtë. Edhe nëse i dhembte gryka, Fani qëndronte medoemos ulur, ndërkohë që prindërit dhe i vëllai i afroheshin. Të rriturit zhdukeshin brenda në shtëpi, kurse vëllai ulej përtokë pranë Fanit. Toni ishte disa vite më i madh se ajo dhe tashmë mund të ndihmonte në fushë. Së bashku ata vizatonin figura në rërë. Fani e përkulte edhe më përpara kokën e saj dhe Toni lakonte qafën, derisa kokat e tyre takoheshin, ballë më ballë. Kur i thërrisnin për të ngrënë, ata ngriheshin, sikur trupat e tyre të kishin fituar

peshtë gjatë të ulurit. Gjatë ngrënies vendi i Fanit ishte pranë të atit. Njëherë ajo u ngjit në prehrin e tij dhe i hodhi duart në qafë. Donte t'i thoshte diçka. Babai përkuli kokën mbrapa dhe prej aty i nguli sytë fëmijës. Fani e pa largësinë që solli ky vështrim, kur babai largoi kokën prej saj. E ndjeu që duart e saj nuk e kishin vendin në qafën e të atit. Ajo i kishte duart pis dhe i ngjisnin. Fani i hoqi duart dhe i vuri mbi kraharorin e të atit për t'u mbështetur. Kraharori i të atit ishte i fortë. Fëmijës i erdhi turp. U largua nga prehri i të atit dhe u ul në stolin pranë tij.

KUR BABAI IKTE NGA KUZHINA, Fani fshihej poshtë tryezës dhe poshtë stolit. Zvarritej prapa, te cepi ku ishte errësirë dhe mbante erë të çuditshme. Fëmija mendonte, se erërat uleshin poshtë. Erërat e ushqimit e të njerëzve në tryezë, fryma e tyre, erërat e rrobave të tyre, e fundeve të mamasë dhe këmishëve të babait. Erërat e enëve, të duarve Së cep, bëhej njësh me të. Poshtë saj ndiente dyshtemë e drunjte, në kurriz dhe nga të dyja anët murin. Trysnia, druri i fortë mbi kokën e saj, e qetësonte Fanin. Nga këtu ajo mund të shihte këmbët e së ëmës, se si vinin vërdallë plot zell. Këmbët e së ëmës përgjithësisht ishin në lëvizje dhe nëse ndonjëherë ndalonin, Fani mund të shihte në to, se ç'punë po kryenin pjesa e sipërme e trupit dhe duart e mamasë. Por ndonjëherë ndodhte që mamaja të ulej në stol dhe të harronte se me çfarë ishte duke u marrë në ato çaste. Rrinte ulur e qetë, si të ishte duke ëndërruar, Fani poshtë stolit të qoshes e dallonte këtë gjendje nga këmbët e mamasë, të cilën ajo e njihnte aq mirë, më mirë se mamatë e tjera. Këmbët e mamasë në këto çaste dukeshin sikur flinin, sikur ishin duke u çlodhur nga të vrapuarit, sikur ishin duke buzëqeshur e mërmëritur në gjumë. Të buta dukeshin këmbët e mamasë në këto çaste. Fani u zvarrit tek ato dhe e vuri një rën dorë mbi një rën pulpë, në mënyrë që ta lajmëronte, përpara se t'i mbinte mamasë nga strofulli ku ishte fshehur. Nëna e vështronte të bijën sikur të ishte duke fjetur. I vendoste krahët rreth trupit të Fanit dhe kokën e

vendoste te koka e fëmijës. Fani ndiente, si merrte frymë e ëma. Ajo heshte. Duart e saj ishin mbi kofshët e mamasë. Kështu duhet të ishte, nëse flije me mamanë në një shtrat. Nuk merrej vesh, ku mbaronte ngrohtësia e trupit tënd dhe ku fillonte ajo e mamasë. Kur Fani ishte shtrirë në shtrat, ajo gjithnjë ndiente konturët e trupit të saj, në të cilat ishte futur batanija. Poshtë batanijes ajo prekte me gishta kornizën e shtratit, atje ishte errësirë dhe ftohtë. Të fjeturit në shtrat me mamanë Fani e përfytyronte si një mbulesë të pakufishme ngrohtësie. Mamaja e kishte ende kokën te koka e Fanit, sikur të ishte duke fjetur. Këmbët u zgjuan para se të zgjohej pjesa tjetër e mamasë. Ndërsa mamaja ende po merrte frymë në qafën e Fanit, duart e Fanit ndjenë se si kofshët e humbën qetësinë. Nën duart e saj, nën cohë e nën lëkurë, Fani ndiente ngutjen e këmbëve, përpara se mamaja t'i hiqte duart nga Fani. Duke u ngritur, shtroi me dorë përparësen. Duhet të kujdesej për komposton, tha mamaja. Fani qëndroi në këmbë edhe për një çast, përpara se të rikthehej poshtë stolit në qoshe. Mamaja shkoi te kthina e zahireve dhe u kthye prapë në kuzhinë. Kur u përkul të merrte një tenxhere nga bufeja, për një çast fytyra e saj u duk në fushëpamjen e Fanit. Kishte një zë, me të cilin mamaja fliste me veten e saj, mund ta dëgjoje atë ose ndoshta edhe jo.



FANI MBAJTI VESH ZUKATJEN NË AJËR, ishte zhurma e diellit. Nën dritën e tij, fëmija pa qenie të vogla pluhuri që kërcenin mbi tokë, që shndërroheshin në dervishë që shtilleshin, kur mamaja përmes tyre shkante te soba, dhe qetësoheshin vetëm nëse ajo rrinte një copë herë atje. Në dritën e diellit, që nëpërmjet dritares së kuzhinës binte pjerrtas mbi dysheme, qeniet prej pluhuri uleshin poshtë pa zhurmë si në ujë, ngadalë ngriheshin prapë sipër dhe ktheheshin si çupëlina të hutuara që vallëzonin vetëm. Fanin e zuri gjumi. U zgjua, kur i vëllai u zvarrit pranë saj poshtë stolit. Toni erdhi të vizitonte të motrën dhe për ta përshëndetur. Fani i vendosi një rënë dorë mbi kokë. Vëllai u ul në bisht pranë saj. Ndërsa dielli zukaft në ajër, dy fëmijët pëshpëritnin poshtë stolit në qoshe. Toni i krihte flokët së motrës me gishtat e tij dhe përpiqej të zgjidhte atë fole me flokë të ngatërruar rrodhe-rrodhe që i bëhej gjithnjë pas koke. Më pas i duhej të ikte, sepse po e thërriste mamaja. Kur Fani dëgjoi hapin e të atit, doli me nxitim nga poshtë tryezës dhe shkoi pranë të ëmës te soba. Nëse babai e shihte poshtë stolit në qoshe, e pyeste mos ishte gjë qen. Fani e dinte, se qentë kishin pleshta dhe nuk duhet të hynin në shtëpi. Si qen rri aty poshtë, i thoshte babai nënës, e cila nuk ia hidhte sytë. Babait nuk i pëlqente, kur njerëzit silleshin si kafshë. Për një grua në fshatin e tyre ai thoshte, se ajo vinte qark tinëz si një mace, me shikimin e saj të shtrembër, kurse priftin e fshatit fqinj e krahasonte me zogjtë që vidhnin farat e fushës. Por më e keqja ishte një njeri që hiqte dorë nga të ecurit me trupin drejt.

NDODHTE, që babai i gjente Fanin dhe Tonin në oborr. Nëse nuk kishin ndonjë gjë për të bërë dhe nuk kishte njeri aty afër, ata shtriheshin në mes të oborrit mbi tokën e ngrohtë. Shtriheshin me kurriz, kokat fare pranë njëra-tjetrës, dhe tregonin histori për ciganët që vinin në atë zonë njëherë në vit. Mamaja i priste ciganët, që ata të drejtonin tenxheret e shtrembëruara dhe të mprihnin thikat. Fani nuk ia ndante sytë burrit që përpunonte tenxheret dhe thikat. Ajo qëndronte te dera e ahurit dhe e vëzhgonte, derisa ai ta vinte re. Ai ngrinte njëren dorë për ta përshëndetur dhe thoshte diçka që Fani nuk e kuptonte. Ajo i afrohej. Donte të dëgjonte se ç'thoshte ai, por mamaja i thërriste që të largohej. Fani duhet të shkonte në shtëpi. Burri qeshte dhe e përshëndeste me dorë. Kur ata rrinin shtrirë me kurriz në oborr, Fani dhe Toni i rrëfenin njëri-tjetrit gjithçka dinin për ciganët. Kryesisht rrëfente Toni, pasi ai dinte më shumë se e motra. Ai rrëfente, se ciganët nuk kishin shtëpi dhe se ata të gjithë ishin muzikantë dhe këndonin me zë të lartë e kërcenin. Përveç kësaj ai kishte dëgjuar, se ndonjëherë ata vrisnin njëri-tjetrin gjatë zënkave. Kur Fani e Toni, tek tregonin këto histori, humbnin vigjilencën e tyre, mbi ta shfaqej babai. Vetëm një sekondë më parë ata, tek flisnin, kishin parë qiellin e paanë e një çast më vonë babai nga lart po i shihte aty poshtë. Ai nuk thoshte asgjë, vëzhgonte të bijtë, të cilët nuk lëviznin dot nën vështrimin e tij. Vështrimi i babait ishte një peshë që i mbante të mbërthyer

në tokë. Fani e dinte që shpina dhe pjesa e prapme e kokës së saj ishin plot me dhé. Rëra e thatë kthehej në ndyrësi nën vështrimin e babait. Ndyrësia ishte ngjitur pas Fanit dhe nëse ajo do të largohej babai do të shihte të prapmen e saj të pistë. Fani dhe Toni ngriheshin në këmbë, pa prekur trupat e njëri-tjetrit dhe pa u parë në sy largoheshin në drejtime të ndryshme. Fani kërkonte ndonjë qoshe, ku të mund të ulej dhe të ngjishte kokën pas ndonjë cope të fortë druri.

KUR FANI U RRI, nuk zvarritej më poshtë stolit të qoshes apo në ndonjë cep tjetër, por kur ishte shtrirë në shtrat, gjatë gjumit e ngjishte kokën pas drurit te koka e krevatit. Shpesh, në mëngjes, i dhembnin koka dhe shpatullat nga shtrëngimi. As histori ciganësh nuk rrëfenin më me të vëllanë, dhe Toni nuk ia krihte më flokët me gishtat e tij. Toni ishte bërë pothuaj aq i gjatë sa babai. Edhe ai ishte i fuqishëm, por fuqia e tij ishte babaxhane dhe muskujt e tij nuk përpiqeshin të dukeshin. Kur uleshin për të ngrënë, babai shqyrtonte të birin. Qafën e ulur, supet që përkuleshin përpara, kraharorin që nuk harkohej. Po të hidhte sytë babai në fytyrën e të birit, do të shikonte se ajo ngurohej gjatë shqyrimit, që muskujt e nofullës tendoseshin dhe mjekra krijonte majuc. Por babai nuk e shihte fytyrën e Tonit. Babai perceptonte qëndrimin te një njeri dhe Toni nuk qëndronte drejt. Më e keqja për babanë ishte, se Toni fliste shumë dhe me qejf. Në çifligun atje në lug ai rrinte i heshtur, por sapo shkonte në fshat, ai llafosej me njerëzit dhe qeshte shpesh me zë të lartë e me gjithë zemër. Babai bënte sikur nuk e vinte re, por Fani e dinte, se për të ishte pothuajse e padurueshme të dëgjonte të qeshurën e papërmbajtur të të birit. Babai gëzonte nam shumë të mirë në fshat. Ai ishte i gjatë dhe hijerëndë dhe e ruante gjithmonë qetësinë. Ai mund t'ia kishte mësuar të birit, se qëndrimi ndodhet në kraharor dhe se kraharori e bën një burrë hijerëndë. Por i biri nuk e kuptonte, se ç' do të thoshte ta mbaje gjithnjë dhe

pa lëvizur qafën drejt dhe kokën lart. Me qëndrimin e tij të patundshëm babai ishte ulur në tavolinë dhe shqyrtonte të birin, ndërkohë që të tjerët gjerbnin supën. Toni ishte përkulur mbi pjatën e tij. Ai rrufiste supën që i pikonte në buzë. Sytë e tij notonin në lot, sepse koka ishte ulur aq afër pjatës, sa avulli i nxehtë i supës i ngjitej në fytyrë. Shikoje si rri, i thoshte babai mamasë dhe fillonte gjithashtu të hante supën e tij. Fani uronte që i vëllai të paktën të ulej drejt, por dukej sikur ai përkulej edhe më shumë me qëllim, që zemërimi i babait të shtohet edhe më. Fani hidhte sytë nga e ëma. Kur babai i thoshte asaj diçka për fëmijët, mamaja mbante frymën e heshtte. Nuk thoshte asgjë dhe nuk e shihte në sy babanë, por Fani kishte vënë re, se mamaja një çast më vonë, kur babai kthente shpinën, ngrihej të bënte ndonjë gjë. Edhe tani u ngrit. Fani ndoqi me sy të ëmën, tek mori një peshqir kuzhine nga mbajtësja e sobës, tek u ul sërish dhe e vendosi peshqirin e kuzhinës pranë pjatës së saj mbi tryezë. Mamaja nuk ishte si gratë e tjera të fshatit. Gratë e tjera shëndosheshin me kalimin e moshës dhe pas çdo lindjeje. Mamaja, përkundrazi, pakej e gjoksi i bëhej çdo ditë më i vogël. Por ajo kishte sjellë në jetë më pak fëmijë se shumica e grave të tjera në fshat. Fani kishte dëgjuar dikë të thoshte, se mamaja më përpara kishte qenë shumë e bukur. Që atëherë Fani kërkonte ndonjëherë këtë bukuri në fytyrën e së ëmës.

FANIT KISHTE FILLUAR t'i interesonte bukuria. Herë pas here vinte re, se babai e vështronte, kur ajo ngrinte sytë lart, pa e ditur se pse. Ai ia ngulte sytë e thoshte, se të të pëlqejë vetja është një mëkat shkatërrues. Fani ndihej si e zënë me presh në duar, sepse ajo me të vërtetë mendonte ndonjëherë për gratë e fshatit që i thoshin se ajo ishte bërë bukuroshe. Për Fanin kjo ishte, si të kishte kaluar matanë në një botë tjetër. Këtu në çiflig ajo nuk do të mundej të bënte asnjë përshkrim të vagullt të pamjes së saj të jashtme, nëse do ta pyeste ndokush. Ajo nuk kishte asnjë përfytyrim të dukjes së saj. Ajo kishte qenë gjithnjë e zënë duke pasur situatën nën kontroll dhe duke mos e dhënë veten, kurse tani mësoi, se jo çdokush mundej të depëronte brenda saj si i ati. Kishte një sipërfaqe midis saj dhe të tjerëve që binte në sy për mirë. Fanit i dukej, sikur kishte bërë një zbulim të vyer e në të njëjtën kohë i dukej, se kjo ishte e pahijshme. Do të kishte dashur ta pyeste Tonin, nëse ai mendonte, se ajo ishte e pashme, por nuk ia mbante. Në shtëpinë në çiflig i vëllai nuk ishte aq i përzemërt sa mes njerëzish të huaj. A thua se ai ishte i aftë të qeshte vetëm nëse largohej paksa nga çifligu në lug. Kur uleshin për të ngrënë, Fani vëzhgonte të vëllanë. Në faqet e tij kishte qimet e mjekrës. Vetullat i kishte deri në krye të hundës. Ajo shihte dhëmbët e tij, kur ai hapte gojën. Toni ngriti kokën dhe ndeshi vështrimin e e saj. Pa e ndryshuar shprehinë e fytyrës, vijoi të hante. Fani lëvizti këmbën poshtë tryezës. Donte t'i gjuante Tonit, me majën e këmbës në mes të kërcirit. Njëherë ai i tha Fanit: Ti je si babi, dhe u largua.

NË KOKËN E FANIT KISHTE NJË MARRAMENDJE TË LEHTË, a thua se gjithçka përnjëherësh kthehej mbrapsht. Pastaj vinte pafuqia. A thua se me një goditje të gjithë shpirtrat e jetës ia kishin mbathur prej saj. Asaj i dukej, se nuk mund të rrinte ulur drejt. Donte të niste të qante me zë të lartë dhe të kërkonte ndihmë. I duhej të shtrinte njërën dorë, verbërisht, për të gjetur njëfarë prekjeje, për të ndier cepin e tryezën nëpër gishta. Ndihej aq keq, sa besonte se do të vllte. Por asnjëherë nuk ndodhte asgjë. Ajo nuk qante kurrë. As nuk bërtiste dhe nuk kishte vjellë kurrë në tryezë. Askush nuk vinte re asgjë. Në të vërtetë trupi i Fanit ishte një masë e palëvizshme. Çdo muskul i ftohur. Parakrahët rënduar mbi tavolinë, këmbët në tokë. Sytë i dignin. Sa për çipat e buzëve as që e dinte se ku ishin. Koka kaq e rëndë. Koka peshonte një kuintal. Fani donte ta linte kokën të binte mbi tryezë, të binte me ballë. Pastaj koka do të vazhdonte të binte, nga njëra anë, me njërën faqe. Fani do të shtrihej me kokën mbi tavolinë dhe nuk do të lëvizte më. Poshtë tavolinës do t'i vareshin krahët. Babai dhe Toni do të duhej ta ngrinin Fanin dhe ta shpinin në shtratin e saj. Atje do të ishin të gjithë rreth saj, do ta mbulonin dhe do t'i mbanin dorën. Në mbrëmje do të duhej që njëri të qëndronte me të në shtrat, të shtrihej fare pranë trupit të saj e të flinte. Çdoherë që përjetonte një çast të tillë, Fani mendonte, se tani do t'i binte vërtet koka dhe pjesa e sipërme e trupit mbi tryezë. Këtë herë nuk do të mund të qëndronte ulur. Besonte

se nuk do të duronte dot më, por nuk rrëzohej. Çdoherë ajo prapë nuk rrëzohej. Meqë nuk rrëzohej, duhet ta mblidhte sërish veten. Derisa të mbaronte darka dhe ajo të mblidhte pjatat e palara, Fani duhet ta mblidhte sërish veten. Duhet të përpiqej të hante diçka. Babait nuk i pëlqente kur nuk hanin. Ajo dhe mamaja ishin ato që ndonjëherë nuk mund të hanin. Me shumë mundësi mamaja njihte të njëjtin pështjellim si ai që kaplonte Fanin gjatë këtyre çasteve. Gjatë këtyre çasteve Fani zihej në pozicionin, në të cilin do ta linin fuqitë. Nëse ajo mundej ta lëvizte kokën dhe të vërente të ëmën, për të parë se sa shumë kishte ngrënë, Fani e dinte se tani ishte më mirë. Ajo dëgjonte zërin e të atit. Ky çast gjithnjë kalonte. Në fillim ndiente sërish shpatullat dhe qafën. Pjesën e prapme të kokës, shtyllën kurrizore dhe fytyrën. Lëpinte buzët. Mbyllte sytë e i hapte prapë, sikur të ishte e re në këtë botë.



BABAI DISKUTONTE, se kur duhej therur derri. Ai i drejtoi një pyetje Tonit, i cili nuk i ktheu përgjigje. Babai pyeti, nëse Tonic nuk i interesonte, se kur do të bëhej therja. Pyeti, ç'dreq fermeri do të bëhej Toni, nëse nuk donte t'ia dinte. Fani e dinte që Toni prej disa kohësh shkonte te njëfarë Maria në fshatin fqinj. Ajo kërkonte diçka në fytyrën e Tonit, por nuk e dinte saktësisht, ç'po kërkonte. Kërkonte këtë Marian, të cilën ajo e përfytyronte si një vajzë bionde që qeshte. Fani përfytyronte, si i vëllai dhe vajza përqafoheshin dhe vajza i ledhatonte kurrizin të vëllait. Kjo ishte një pamje që Fanit nuk i hiqej nga mendja. E pyeti të vëllain: Po kjo Maria jote nuk është bujkeshë? Babai shtyu tutje pjatën e tij të zbrazët. Toni ngriti kokën, vetëm aq, sa ishte e nevojshme për të parë Fanin. Për një çast Fani kishte ndier triumf, por tani e kuptoi, se diçka i kishte marrë të vëllait me atë pyetje. Babai nuk tha asgjë. Ata e dinin, se ai do ta zbulonte, si ishte puna me këtë Marian. Nuk e dinin, si do ta zbulonte, sepse ai nuk para bisedonte dhe nuk shkonte pothuajse kurrë në lokal, por do t'ia dilte. Fani përfytyronte, sesi babai e dinte saktësisht, se kë duhet të pyeste. Përfytyronte, si ai do të dilte në fshat. Në pyllin përpara zjarrfikëses do të qëndronte bujkeshja e Mullirit, e cila gjithmonë dinte gjithçka për gjithkënd, duke radhitur drutë. Babai do ta përshëndeste dhe do ta pyeste, si ishte. Pastaj do t'i drejtonte pyetjen e tij. Bujkeshja e Mullirit do t'i tregonte gjithçka dinte, sikur t'i jepte llogari një inspektori policie dhe të ishte e detyruar të thoshte të vërtetën. Babai do të thoshte edhe diçka për motin dhe të korrat dhe më pas do të ndaheshin dhe babai do të kthehej në çifligun në lug. Toni nuk do t'i fliste më me gojë Fanit.

FANI NUK E KUPTONTE, pse i vëllai nuk ishte krenar për të atin, të cilin e respektonin aq shumë në fshat. Fani mbaronte të shkonte me të atin mes njerëzve. Pranë tij ishte kaq e thjeshtë ta mbaje trupin drejt. Nëse vëllai do të shkonte njëherë me babanë mes njerëzve, shpina e tij do të drejtohej vetvetiu dhe ai do të mësonte të rrinte drejt. Kur Fani shkonte me të atin mes njerëzve, shpatullat e tij, në vijë të drejtë me kokën e saj, e tërhiqnin sipër dhe i drejtonin kurrizin. Sikur të ishte e lidhur me të atin përmes penjsh të padukshëm, Fani ecte përkrah tij dhe gjallërohej nga prania e tij. Ajo u buzëqeshte njerëzve, të cilët babai i përshëndeste me një të tundur të kokës, dhe e pranonte respektin e tyre ashtu si një mbretëreshë pranonte nderimet e popullit të saj. Vihej re njëfarë druajtjeje në sjelljen e të tjerëve kundrejt të atit, veçanërisht te burrat, të cilët e shndërronin këtë druajtje në një pamje hijerëndë dhe flisnin me të atin, si të ndanin me të një përgjegjësi të madhe. Fani e njihte mirë këtë druajtje, ajo ndihej shpesh shumë e dobët para të atit, por kur ecte krah tij si e bija, krenaria e tij i përçohej edhe asaj.

KUR FANI i tregoi të mbesës historinë e rrëmujës para kishës, fëmija e dëgjonte me vëmendje, pa e parë Fanin në sy, zhytur në përfytyrimet e saj, siç dëgjohet një përrallë e frikshme. Vetëm një herë Fani ishte bërë bashkë me vajzat e Bashkësisë së Vajzave Gjermane në grupin rinor të Hitlerit. Ndodhi një ditë të diel gjatë meshës. Fani ia doli të qëndronte pa u vënë re përpara kishës, ndërkohë që të tjerët hynë brenda. Siç kishin rënë dakord, vajzat po rrinin jashtë. As nja dy burra të moshuar, të cilët e dinin se grupi i vajzave po planifikonte diçka, nuk u futën në kishë. Kur filloi mesha, vajzat marshuan në rreth dhe kënduan një këngë që Fani nuk e njihte, sepse ishte për herë të parë aty. Me bisht të syrit Fani pa, se nga kisha po dilte edhe ndonjë njeri tek-tuk, i dëgjonte burrat e vjetër tek shanin. Fani e ndiente vëmendjen përreth që po rritej gjithnjë e më shumë dhe ankthin që po shtohet. Pa drejt, tek vajza para saj dhe nuk këndoi bashkë me të, pasi ajo nuk e njihte tekstin, por edhe sepse zëri i saj nuk do t'i ishte bindur. Diçka dukej se po ndehet midis kokës së Fanit dhe trupit të saj. Në veshët e Fanit këndonte një tonalitet i lartë që dilte mbi zërat e errët të vajzave. Ajo ndjeu, përpara se ta kthente kokën, që babai kishte dalë furishëm nga kisha. Ai e njohu Fanin menjëherë midis vajzave të tjera dhe shkoi drejt saj. Fani i bëri ballë impulsit për të ikur me vrap. Vajzat nuk po marshonin më dhe kishin ndaluar së kënduari. Ato bënë një hap prapa duke i hapur rrugën babait, vetëm Fani qëndroi në vend. Tashmë

shumica e njerëzve kishin dalë nga kisha. Fani e dinte, se të gjithë po shikonin, por ajo kishte sy vetëm për të atin. Dukej, sikur babai donte ta vriste dhe nuk po përmbahej dot. Trupi i Fanit po dridhej, por nuk ia mbathi. Ajo shihte pa lëvizur fytyrën e të atit, që ishte bërë xhind. Nuk dallohej më, ku ishte goja, hunda dhe sytë. Fytyra e babait ishte një pështjellim i vetëm fytyre që bërtiste dhe Fani e dinte ç'ë priste. Më në fund babai ishte pranë saj. Hunda, goja dhe faqet e babait shkuan në vendin e tyre. Fani ngriti mjekrën, i drejtoi ballin qiellit dhe i ndjeu qepallat e njoma, kur për një çast mbylli sytë. Babai ngriti njërin krah dhe e qëlloi Fanin në faqe. Pastaj u kthye mbrapsht dhe u largua, u kthye në çifligun në lug. Nën vështrimet e vizitorëve të tjerë të kishës dhe mermërimave të tyre, që sapo kishin nisur, Fani shkoi pas të atit. Diku nga mbrapa po vinin mamaja dhe vëllai. Fani nuk i hodhi sytë përreth. Ajo ishte mbushur me një gëzim të egër, që e mbajti gjithë ditën dhe vijoi të dallgëzonte përmes trupit të saj, edhe në mbrëmje kur ishte shtrirë në shtrat dhe nuk e zinte gjumi.

EDHE GJASHTËDHJETË VITE MË VONË trupin e Fanit e përshkonte jehona e atij gëzimi të egër. Ishte e lumtur që pikërisht ky kujtim ishte rizgjuar rastësisht. Qëkur nuk e kishte më idenë e kohërave, as trupi nuk i bindej më. Fshehtas, pa ndërhyrjen e Fanit, trupi kishte ruajtur gjithçka ndër vite. Dhe tani që ishte aq i dobët, se Fani ushqehej fare pak dhe trupi nuk kishte më asgjë për të bërë, kujtimet ishin si procese organike, të cilat ishin të pavarura dhe pa ndonjë komandë të vullnetshme. Dikur kishte menduar, se i kishte trupin dhe kujtesën nën kontroll. Tani rrinte shtrirë e humbur në shtratin e saj martesor dhe qeshte në qetësi, sepse kishte qenë aq budallaqe. Vazhdimisht shihte ëndrra. Megjithëse Fani nuk kishte më gjumë, por dremitje dhe zgjime, dhe megjithëse gjendjet e kaluara prej kohësh dhe të kujtuara, ngatërroheshin me njëra-tjetrën, ajo nuk mundi asnjëherë të vetme të dilte nga kjo ëndërr. Kur e gjente veten papritur pranë të vëllait të veshur me një kostum të zi, Fani e dinte, se ishte prapë momenti dhe çdo përpjekje për t'u mbrojtur ishte e kotë. Kthente kokën anash dhe lëvizte duart mbi çarçaf për të protestuar. Ndonjëherë ngrihej dhe prapë fundosej, por nuk mund të ndërmernte asgjë kundër asaj ëndrre.

ISHTE DITA, kur u varros motra e të atit. Ishin zvarritur poshtë stolit të qoshes dhe mamaja më pas shkundi pluhurin nga kostumi i zi i Tonit. Në fakt Tonin nuk e nxinte më hapësira poshtë stolit. Ai u ul në dysheme përpara strofullit të Fanit dhe vetëm këmbët kishte te Fani poshtë stolit të qoshes. Fani dhe i vëllai nuk e kishin njohur motrën e babait dhe ajo u varros në një vend, ku ata nuk kishin qenë kurrë. Ecën në këmbë, jo në drejtim të qytetit të vogël, por shumë afër kufirit. Babai dhe nëna ecën përpara, Fani dhe Toni nga pas me njëfarë distance. Toni ishte krenar për kostumin e tij të zi, i cili dukej tamam si i babait, vetëm se më i vogël. Edhe Fani do të kishte dashur një kostum të tillë në vend të fustanit të ngrirë që ishte dashur të vishte. Gjatë gjithë ditës Toni kishte qenë krah të atit, kurse Fanin e mbante e ëma për dore. Fani vëzhgonte Tonin, se si ai bënte gjithçka si i ati. Në varreza ai qëndronte pranë të atit dhe imitonte seriozitetin e fytyrës së tij. Shumë njerëz nuk ia dhanë dorën vetëm babait, por edhe Tonit, i cili i falënderonte me të njëjtën lëvizje të prerë të kokës, siç e kishte parë nga babai. Dorën e Fanit e mbante e ëma. Disa gra i ledhatonin kokën Fanit. Edhe më pas në lokal, Toni ishte ulur pranë të atit. Ai bënte sikur dëgjonte të rriturit tek bisedonin dhe nuk donte të dilte jashtë me Fanin. Kur ishin prapë te çifligu në lug në mbrëmje vonë, Fani dhe Toni vinin vërdallë nëpër shtëpi. Askush nuk u kishte dhënë urdhër të binin për të fjetur. Toni ende mbante veshur kostumin e tij të zi. Përfunduan para derës së dhomës së gjumit të prindërve, që ishte e hapur një

pëllëmbë. Pa folur, u përvodhën më afër të çarës së vogël te dera dhe panë brenda.

Fani në fillim nuk e kuptoi atë që pa. Pastaj i ra në të, që babai, i veshur me këmishë, ishte ulur te cepi i krevatit dhe para tij ishte gjunjëzuar e ëma. Mbi shpinë mamasë i ishin përhapur flokët, që ajo i zgjidhte vetëm përpara se të shkonte në shtrat. Fani e kuptoi, që mamaja po i hiqte këpucët babait. Duart e babait shtriheshin mbi mbulesën e krevatit si kafshë të vogla, urithë, të cilët ishin kafshuar nga macet për vdekje. Supet e babait ishin përkulur përpara. Kraharori i rënë. Fytyrën Fani nuk guxoi t'ia shihte sërish. Fytyra e babait dukej, sikur ai të ishte qëruar nga sytë. Sytë e babait ishin të zinj si kostumi i Tonit. Mamaja u mbështet mbi krevat dhe me një psherëtimë drejtoi trupin. Kur ishte para të atit, ai i hodhi krahët në bel dhe shtypi kokën në barkun e saj. Përpara derës së dhomës së gjumit Fani ndjeu atë tmerr si të ishte duke ndodhur në trupin e saj. Donte të ikte, por ja që nuk i largohej dot kësaj skene. Mamaja përkëdheli kokën e babait. Fani dëgjoi zhurma të mbytura. Mamaja hoqi duart e babait nga ijët e saj dhe bëri një hap prapa. Fani pa fytyrën e të atit. Ishte e lagur. Babai kishte hapur gojën fort, prej andej erdhi një gurgullimë. Pastaj një dënesë. Babai po qante. Mamaja kishte filluar të zhvishej. Ajo hoqi fustanin dhe këmishën e nëntëshme. Fëmijët përpara derës së dhomës së gjumit panë këmbët e saj lakuriqe. Mamaja hoqi kanotierën nga koka. Fëmijët panë gjinjtë e saj të bardhë në profil. Mamaja i hoqi babait këmishën dhe pantallonat dhe u shtri pranë tij në shtrat. I tërhoqi kokën në gjoksin e saj dhe i foli me zë të ulët kokës së babait që po gurgullonte e dëneste. Dy fëmijët u larguan vjedhurazi. Ikën secili më vete, a thua se tjetri nuk ishte fare aty.

FANI U SHTRI NË SHTRATIN E SAJ dhe ra në një gjumë të rëndë. Kur u zgjua, ishte ditë. U ngrit dhe mbante veshur rrobat e një dite më parë. Nga dhoma doli jashtë në korridor. Asnjë zhurmë nuk dëgjohej, madje as hapat e vetë asaj, megjithëse dysHEMEJA prej druri gjithmonë më parë kishte kërkëllirë. Fani zbriti shkallët në drejtim të kuzhinës. Lëvizte sikur ajri rreth saj mund të grisej nga ndonjë lëvizje e pakujdesshme. Pa nxjerrë asnjë tingull kaloi nëpër shtëpinë e prindërve. Para derës së mbyllur të kuzhinës ndaloi. Nga brenda vinte një rrapëllimë, sikur po rrëzoheshin karrige dhe binin gjëra përtokë. Ishte sikur harbohej në kuzhinë qoftëlargu. Fani e përsëriti me vete këtë fjalë. Qoftëlargu. Nuk dëgjohej asnjë zë, asnjë tingull njerëzor, vetëm rrapëllima dhe zhurmë gjërash që binin e pastaj një zallahi që e llahtarisi. Nga tmerri Fani u ul drejt në shtratin e saj martesor. Zemra i pulsonte kaq fort, sa i dhembnin brinjët nga rrahjet e saj. Do të jetë prapë ajo ëndërr e urryer, mendoj Fani, që zemra e saj nuk do të mund ta përballonte edhe njëherë.



QETËSIA ERDHI ME LUFTËN. Në çifligun në lug asnjëherë nuk kishte pasur shumë shamatë. Babait nuk i pëlqenin njerëzit e zhurmsëm, për të ata ishin të paparashikueshëm dhe të pabesë. Por qetësia që kaploi çifligun, kur Toni duhet të shkonte në luftë, ishte tjetër. Ndonjëherë Fani ulte kokën të shihte veten. Shihte krahët e saj të shtrirë e megjithatë nuk i ndiente. Qëndronte në mes të çifligut dhe i linte krahët të binin pa fuqi. Me mundim hidhte sytë mbi fushat në drejtim të kodrës, mbi shpinën e së cilës pikasi siluetën e një burri. Nuk mund të dallonte, nëse ai po lëvizte në drejtim të fshatit apo ishte duke u larguar prej tij. Mamaja po vinte nga ahuri, kaloi nga Fani dhe tha, eja të qërosh patate. Aq sa Fani mbante mend, ajo kishte qëruar patate bashkë me të ëmën. Gjithnjë kishin qenë ato çaste që i sillnin të dyja së bashku në tryezën e kuzhinës. Uleshin përballë njëra-tjetrës, çdonjëra me një thikë të vogël në dorë, përpara tyre një mori patatesh dhe një tenxhere e madhe, ku ato hidhnin patatet e qëruara. Në çdo stinë e çdo kohë të ditës ato duhet të jenë ulur kështu. Mund të binte shi e borë, ndërsa ato qëronin patate; bënte nxehtë e ftohtë, shpesh ndriçonte dielli, ndërsa Fani dhe e ëma qëronin patate. Por në kujtesën e Fanit kishte një çast gjithmonë njësoj të të qëruarit të patateve. Nga dritarja e kuzhinës qielli ishte në një të kaltër shumë të çelët, pothuaj i bardhë, e pamundur të dalloje stinën prej tij. Nuk frynte erë. Fani nuk kujtohej të kishte ardhur ndonjëherë ndokush

në kuzhinë, ndërsa e ëma dhe ajo qëronin patate. A thua se ato ishin të vetmit njerëz në botë. Flisnin për gjithçka, por shumicën e rasteve heshtnin. Fani kishte mësuar nga e ëma të qëronte patate që kur kishte qenë vajzë e vogël. Të dy parakrahët ishin mbështetur në tryezë, dora e majtë mbante në zgavrën e saj një patate. E djathta e shtynte me gishtin e madh dhe e rrotullonte dhe i qëronte lëkurën rreth e rreth me thikë, nga lart poshtë. Pastaj, me kurrizin e dorës, hidhnin lëkurat në një piring, ndërsa me dorën tjetër kapnin pataten e radhës. Në luftë kishte më pak patate për të qëruar e Fani dhe e ëma flisnin edhe më pak se më parë dhe mendonin për Tonin, nga i cili prej kohësh nuk kishte ardhur më asnjë lajm. Kur lufta u thellua edhe më, Fani dhe e ëma nuk bënë më brumë patatesh dhe as toptha me brumë patatesh. Ato i zienin patatet dhe i hanin me lëkurë.

ISHTE LUFTË, kur njëherë Fani rrëshqiti nga stoli; ishte vetëm në kuzhinë. Nuk lëvizi, vetëm e la trupin të rrëshqiste ku të donte ai, sikur t'i bindej një ligji të natyrës. Si në mënyrë të pavullnetshme, Fani rrinte ulur poshtë tryezës mbi dysheme. Po e sheshonte trupin edhe më, sikur të donte të provonte, se çfarë ndodhte, nëse vetëm e linte të lirë trupin e saj. U shtri sa gjatë gjerë poshtë stolit. Kokën e kishte te cepi, ku dikur ulej galiç. Fani ngjeshi kokën me sa forcë kishte, pas murit dhe e shtyu trupin edhe pak. Thithte erën që nuk kishte ndryshuar, megjithëse i vëllai nuk ishte më atje dhe në të vërtetë gjithçka ishte ndryshe. Këtu poshtë ishte ende ajo përzierje ushqimi dhe gojësh, përparësesh, këmishësh dhe këpucësh, supesh, rrobash të lagura dhe mish viçi, sane, pelteje boronicash dhe këmbësh të zbathura në ditë të nxehta. Kur dëgjonte të vinte dikush, Fani sërish zvarritej poshtë tryezës, me mundim, a thua se trupi i saj papritur ishte bërë shumë i madh, a thua se një vajzë e vogël ishte fshehur poshtë stolit në qoshe dhe befas kishte arritur madhësinë e një përbindëshi. Ishin hapat e mamasë, e cila hyri në kuzhinë dhe nuk e vuri re fare, që Fani po shkundte pisllekun nga përparësja. Mamaja tha se prapë i dukej sikur kishte parë thataniken në stol. Qeshi me zë të ulët dhe doli sërish. Disa kohë përpara se Tonit t'i duhej të shkonte në luftë, thatanikja plakë kishte vdekur, ndërsa rrinte ulur te stoli para shtëpisë. Deri në mbrëmje nuk e kishte vënë re njeri.

FANI PO VËSHTRONTE PËRMES DRITARES SË KUZHINËS jashtë në çiftig dhe pa babanë duke ecur. Qëndrimi i tij ishte i pandryshuar, por Fanit i dukej sikur babai ishte futur në qëndrimin e tij, si në një korse. Mendoi se babai do të shpërbëhej po të zgjidhej korseja. Pas qëndrimit të pandryshuar babai ishte i lodhur. Fani vuante bashkë me të. Ajo e ndiente, se i gjithë trupi i babait dhembte. Njëherë ai u ul te tryeza në kuzhinë, ku ishte ulur Fani dhe po armonte një këmishë. Ai vendosi duart mbi tryezë dhe më pas, me shpinën drejt dhe shpatullat e gjera, përkuli pak qafën, me vështrimin drejtuar te duart e tij. Fani e ndiente, se trupi i babait ishte bërë një trup që dhembte. Po aq e rëndë dhe e fortë sa trupi, ishte edhe dhembja e tij. Do të kishte qenë më mirë, nëse babai do të ishte trupvogël dhe i hollë, kështu do të kishte më pak vend për dhembjen. Në një mënyrë që edhe mund mos ta dëgjoje, po të doje, Fani e pyeti, nëse i dhembte diçka? Babai i tha: Gjithçka, Fanushe. Qysh atëherë Fani ndonjëherë rrinte prapa tij, kur ai ulej në tavolinë. Sikur shkonte aty rastësisht dhe ndalonte rastësisht në këtë vend, ku duart e saj vinin si zogj nga ajri dhe vendoseshin mbi shpinën e babait. Duart përshkonin shpinën sa lart poshtë. Shpina përbëhej nga dy degënaja të drejta në mes e dy pllaka të mëdha, të rënda poshtë shpatullave, të cilat shkriheshin nga pak nën presionin e fortë të gishtave. Për një moment babai ngrinte kokën. Në të njëjtin çast duart ngriheshin në ajër. Fani sapo kishte kaluar

pas babait dhe ulej sërish në vendin e saj. Babai ngrihej dhe dilte përjashta. Qëkur i vëllai ishte në luftë, Fani kishte frikë, se do të vinte një moment që babai do të ngurtësohej. Çdoherë, kur i fërkonte shpinën, Fani lehtësohej, sepse e kishte shtyrë edhe pak ngurosjen përfundimtare. Kur shtati i babait forcohej si rrëshirë, nga jashtë brenda, mamaja bëhej gjithnjë më e tejndritshme. Fani ndonjëherë mendonte se e ëma ishte ndonjë fantazmë shtëpie, kur shkonte tinëz nëpër dhoma e në çiflig ose kur zhdukej në errësirën e ahurit. Fani kishte dalë në dritare dhe po shikonte jashtë. Një kolos që po ngurosej u shfaq para syve të saj. Atje, ku ajri dukej se vezullonte, lëvrinte një qenie e ndritshme. Fani uronte që vëllai të shfaqej te porta, ashtu papritur pa kujtuar, të ndalonte një çast dhe të ngrinte sytë lart tek ajo që po rrinte në dritare. Pastaj ai do të hynte në çiflig dhe me çdo hap që hidhte, konturët e kolosit do të zbuteshin, dhe sa më shumë të afrohej, aq më shumë ngjyrë do të merrte fantazma e shtëpisë. Fani u mbështet me kokë pas murit. Poshtë saj mbi dërrasat e dyshemesë pa dritën e diellit. Sipër në kokë ndiente murin. Me gjithë peshën e saj u mbështet pas tij.

EDHE GJATË LUFTËS Fani shkonte dy herë në javë në Shkollën e Ekonomisë Shtëpiake në qytetin e vogël. Megjithëse askush nuk dinte se ç' do të ndodhte, ata ishin të bindur se vëllai do të merrte përsipër çifligun në lug dhe Fanit nuk do t'i duhej të martohej me ndonjë trashëgimtar çifligu nga fshati apo nga ndonjë prej vendeve aty afër. Pjesa më e madhe e vajzave në moshën e Fanit ishin të martuara ose e dinin, me kë do të martoheshin së shpejti. Kur Fani kuptoi, se ç' ishte kjo puna e martesës, i vëzhgoi me vëmendje djemtë e rinj. Vëzhgonte, se si deheshin nëpër festa dhe se si gjithmonë kishte disa, që më pas, të skuqur në fytyrë dhe me sokëllimë, rriheshin me njëri-tjetrin. Ajo e kuptoi se çfarë nënkuptonte babai, kur thoshte që burri duhet të ketë një qëndrim. Ajo i tregoi të atit, se si djelmoshat ishin rrahur gjatë një feste për ardhjen e verës dhe babai i tha se alkooli ishte punë e shejtanit. Babai thoshte se ajo nuk duhet të martohej me askënd që shkonte në lokal. Fani konstatoi se babai ishte i vetmi burrë në fshat, i cili nuk ulej rregullisht në lokal. Ajo vinte re se djemtë e rinj nuk guxonin ta shihnin në fytyrë. Kur Fani ndeshte ndonjë djalosh vetëm, ai shihte vërdallë, a thua se po e ndiqnin. Fani konstatoi se djelmoshave u mungonte krenaria dhe kur përmendi se kishte dëshirë të vizitonte Shkollën e Ekonomisë Shtëpiake, babai ra dakord. Duhet të jesh e pavarur tani, tha ai.

NDONJËHERË BABAI PYESTE për mësimin në Shkollën e Ekonomisë Shtëpiake, të cilën ai e quante Shkolla Ekonomike. Fani i rrëfente për qepjet dhe gatimet, për mësueset. Për notat e tyre. Ajo nuk e përmendte, që në klasën e saj ishte e vetmja që vinte nga një fermë fshati. Nuk tregonte për gjërat që ishin shumë më ndryshe se ç’i njihite babai dhe se ç’i kishte njohur Fani. Për shumë nga gjellët që mësonin të përgatisnin Fani nuk tregonte. As për librin që u kishin dhënë dhe ku zonja e shtëpisë kishte servise dhe takëme të panumërta të ngrënies dhe gota të caktuara për çdo pije, ku kishte një dhomë ngrënieje dhe një sallon duhani për zotërinjtë. Ekonomia për Fanin deri tani kishte qenë ajo bujqësorja, kurse tani e mësoi, se mund të bëhej fjalë edhe për ekonominë e shtëpisë, pa tokë e pa bagëti. Shumica e vajzave në Shkollën e Ekonomisë Shtëpiake ishin bija nëpunësish të shtetit, mësuesish, njëra kishte për baba gjykatësin e qytetit të vogël. Fani i rrëfente të atit se, sipas mësueses, asaj i jepej shumë në rrobaqepësi. Ajo nuk rrëfente për fletoret me figura dhe vizatime bluzash dhe pantallonash prej copash të holla, të derdhura dhe fustanesh të rafinuara fare pa kuptim. Fani nuk rrëfente as për orën e vallëzimit që bija e gjykatësit ua jepte disa vajzave gjatë pushimit. Ndonjëherë ato qëndronin në shkollë, edhe pasi mbaronte mësimi, në mënyrë që të ushtroheshin. E bija e gjykatësit shkonte në të vetmen shkollë vallëzimi në qytetin e vogël. Fani nuk duronte dot kur ajo bënte si e rëndësishme

në rolin e saj si mjeshtre vallëzimi, por vallëzimi i pëlqente, edhe pse ishte pa muzikë. Numërimi i hapave nga bija e gjykatësit mbetej disi enigmatik për Fanin, sepse ajo nuk i dëgjonte asnjëherë meloditë. Bija e gjykatësit ose numëronte, kryesisht deri në katër, ose këndonte nën hundë, por kurrë nuk ua shpjegonte nxënëseve të saj, ç’lidhje kishte numërimi me të kënduarit nën hundë. Asnjë mësues nuk ishte në dijeni për këto orë mësimi, të cilat pavarësisht zërit që numëronte dhe hapave të katër ose pesë vajzave, mbeteshin çuditërisht të qeta. Në fund, e bija e gjykatësit thoshte me zë të lartë se vallëzimi me djem ishte vërtet i pakrahasueshëm.



EDHE PASI KISHTE NISUR LUFTA, Fani merrte rrugën dy herë në javë herët në mëngjes për të marshuar në këmbë disa orë me radhë për në qytetin e vogël. Rruga kishte të përpjeta dhe të tatëpjeta të shumta dhe që te malorja e parë e gjatë Fani ndiente vapë. Nga lodhja merrte frymë më shpejt. Çdo frymëmarrje e ndiente në kraharor dhe në të gjithë trupin nga mesi e lart. Kishte lënë pas më shumë se gjysmën e rrugës, larg nga heshtja e shurdhët e çifligut në lug, përpara se të bënte një pushim të shkurtër para një maloreje. Vështronte mbi kodra, të cilat shtriheshin para saj dhe ngrinin kurrizin e tyre dhe e ulnin sërish. Midis pjesëve të errëta të pyllit kishte fusha dhe lëndina të ndara me stome. Stomet sheshoheshin nga gurët dhe ishin mbushur me mëshstekna, ferra trëndafilash të egër dhe bar të fortë. Këta gurë gri mbizotëronin në të gjithë zonën. Me ta ndërtoheshin çifligjet, ahuret, kufijtë dhe varret. Mbi ta preheshin fushat me relievet dhe lugjet e tyre. Mu në mes gjeje ndonjëherë ndonjë shkëmb erratic, ndonjë mollok gjigant shkëmbi, të cilin askush nuk do ta largonte ndonjëherë prej aty. Pjesën më të madhe të rrugës Fani e kishte në pyll. Ajo nguliti në mendje pjesët, ku rriteshin ferra boronicash, për t'u kthyer sërish kur boronicat të piqeshin. Në pyll lufta nuk kishte ndryshuar asgjë, edhe zhurmat kishin mbetur të njëjtat. Në udhën e Fanit për në qytetin e vogël ishte vetëm një pjesë e vogël, ku ajo kalonte në rrugë. Këtu e parakaloi njëherë një makinë me ushtarë. Ajo pa që në karroceri ishte shtrirë

dikush e nuk lëvizte. Një këmbë varej jashtë karrocerisë dhe kërcente sipas përthyerjeve të rrugës. Që nga ajo ditë Fani nuk kalonte nga rruga në asnjë pjesë të udhës së saj, madje as atje, ku pyllin e përshkonte një llogëm i gjerë. Deri tani, gjatë ecjes, ajo kishte marrë frymë lehtë e thellë. Kurse tani frymëmarrja i shpeshtohej papritur dhe një shije e mprehtë depërtonte nga gjoksi në grykë e ndonjëherë deri në gojë dhe e nxiste të ecte më shpejt, të vraponte, derisa të shihte kullën e kishës së qytetit të vogël. Pak kohë më vonë morën një diplomë dhe shkolla mbaroi. Lufta vazhdonte dhe nga vëllai nuk kishte asnjë lajm.

KUR MBESA ISHTE E VOGËL, ajo fiksonte fjalë të veçanta, me të cilat mund të kërkonte njëherë prej historive, që Fani ia tregonte si përrallë. Njëherë ajo donte të dëgjonte historinë e mbretëreshës. Fani u mendua, mos i kishte treguar ndonjëherë ndonjë përrallë me mbretëreshë të *Vëllezërve Grim*, por më në fund, pasi filloi shumë histori dhe fëmija e ndërpreu çdoherë, Fani e kuptoi për se bëhej fjalë. Ajo pikasi, që fëmija kishte të drejtë. Bëhej fjalë për përrallën, se si Fani ishte bërë mbretëreshë. E prandaj fillonte me mbërritjen e princit. Fani qeshi, por fëmija tha e vendosur: Jo princi, mësuesi. Fanit iu desh të niste edhe njëherë nga e para. Historia duhet të fillonte gjithnjë me të njëjtën fjalë. Pas luftës, në fshat erdhi një mësues i ri. Dhe ky mësuesi i ri, tha Fani, ishte një burrë i gjatë, shpatullgjerë, me flokë të errët, të cilit, që në vitet e rinisë së hershme, i kishin rënë pak flokët në të dyja anët e ballit. Ai nuk ishte bujk, rrëfeu Fani, ishte më i zgjuar se gjithë të tjerët në fshat. E respektuan që në fillim dhe dukej, sikur kishte qenë gjithnjë në fshat. Dhe, tha Fani, dhe zëri i vet i tingëlloi në vesh më i lartë e më i çelur, dinte të buzëqeshte shumë bukur. Ai e mori Fanin në makinë e tij për të vallëzuar së bashku në një nga qytezat aty afër. Mësuesi i ri ishte i vetmi në fshat, krahas priftit, që kishte makinë. Në qytetin aty afër, në rrugën kryesore, kishin nxjerrë jashtë tavolina dhe stola dhe mund të qëlloje në një tabelë qitjeje. Në një lëndinë anës rrugës po vallëzohej. Për herë të parë Fani po vallëzonte

me një burrë. Ajo i kishte përfytyruar ndryshe zotërinjtë në shkollën e vallëzimit të së bijës së gjykatësit, disi më të zhdërvjellët, por mësuesi i ri dinte të vallëzonte. Në fund të fundit ai ishte edukuar mirë, tha mësuesi dhe buzëqeshi, a thua se bëri ndonjë shaka. Fani ishte e lumtur, që mund të thoshte, se kishte ndjekur shkollën ekonomike. Në fillim ajo u përqendrua te këmbët e saj. Mësuesi i kërkoi disa herë, që gjatë vallëzimit ta vështronte atë, kështu që Fani e detyroi veten ta mbante kokën lart, megjithëse kishte ndjesinë se nuk i kishte këmbët nën kontroll, nëse nuk i shihte. Kjo nuk kishte të bënte aspak me hapat para e prapa e anash gjatë orëve të vallëzimit, ajo pengohej me ngathtësi si zullape fshatare në krahët e mësuesit të ri. Sikur ai ta lëshonte papritur, ajo do të rrëzohej në lëndinë, ishte qyqare. Fani ndjeu t'i mblidheshin lotët në fyt. Ajo kishte menduar, se do të mund të vallëzonte dhe ishte bërë qesharake. Fani nuk e kishte më mendjen te këmbët, por te sasia e lotëve. Nuk duhej në asnjë mënyrë që ata të shtoheshin aq shumë, sa sytë mos t'i mbanin dot. Pa supet e mësuesit dhe qafën e tij. Lëkurën mbi jakën e këmishës, fare pranë. Ndjeu dorën e tij në shpinën e saj. Mësuesi buzëqeshte. Më në fund Fani kujtoi çka u kishte mësuar bija e gjykatësit. Numërimi i thatë dhe hapat e mistershëm krijuan një lëvizje, bashkë me muzikën dhe nën drejtimin e mësuesit. Ata po vallëzonin në qoshe. Lëndina nuk ishte rrethuar me gardh, por kishte një kufi, deri atje, ku shkonte ndriçimi i rrugës kryesore. Edhe britmat e thirrmat mezi depërtonin deri këtu. Nëse Fani dhe mësuesi do të kishin bërë edhe disa hapa drejt fushës së errët, zhurma do të kishte reshtur.

KUR MËSUESI I KËRKOI FANIT të bëhej gruaja e tij, të gjithë në fshat mendonin se ata shkonin shumë bashkë. Martesa e tyre ishte e para që u bë në kishën e sapondërtuar me gurë në fshat. Ajo ishte ndier, tregonte Fani, sikur në këtë ditë të ishte kurorëzuar mbretëreshë. Çatia e kapelës së vogël ishte një kupolë e gjerë dhe kambanat dëgjoheshin deri përtej fushave, ku askush nuk po punonte, sepse të gjithë kishin ardhur të shikonin, si martoheshin mësuesi dhe Fani. Të gjithë ishin në një mendje, se kurrë nuk kishin parë një çift kaq të bukur. Gjyshi yt ishte burrë i pashëm, i tha Fani të mbesës. Ku është gjyshi, pyeti fëmija, kur e dëgjoi këtë për herë të parë. Ka kohë që ka vdekur, tha Fani, sikur sapo t'i ishte kujtuar kjo gjë. Ajo vuri re se kishte heshtur, vetëm kur u zgjua nga mendimet e saj. Përpara saj ishte ulur fëmija që po e vëzhgonte. Shpesh Fani kishte ndjesinë e çuditshme, se fëmija e njëjtte të kaluarën e fshatit, megjithëse nuk kishte qenë kurrë atje. A thua se ajo mund t'i shihte pamjet, pa ia treguar Fani. Ishte bijë mbreti. Gjyshi yt ishte mësuesi i fshatit, i tha Fani të mbesës, të cilës i pëlqente shumë kjo fjalë. Ditën që u martua, Fani u zhvendos nga çifligu në lug në ndërtesën e shkollës që ngrihej sipër në kodër. Që tani ajo do të quhej mësuese. Fani rregulloi banesën e mësuesit në katin e parë dhe filloi të mbarështojë kopshtin me perime prapa godinës së shkollës. Që nga kopshti do të kishte qenë e mundur të shihte lugun, sikur të mos i pengonte shikimin baxhoja e

vjetër. Më parë në baxho kishte banuar administratori i zonës, tani atje banonin punëtorët e pyllit dhe të fabrikës së sharrës. Fani ndihej si të kishte ecur nën një re të mbushur, tani që ishte zhvendosur mbi kodër. Gjithmonë, kur ishte në kopshtin me perime dhe vështronte mjedisin përreth dhe baxhon, që ishte direkt para lugut, Fani befas merrte frymë thellë dhe vinte re se kishte mbajtur frymën pak më parë. Prifti, që gjithashtu kishte ardhur i ri, shkante me kënaqësi për vizitë te Fani në ndërtesën e shkollës. Ata flisnin për fëmijët e shkollës, të cilëve u jepej shumë pak për të ngrënë, dhe Fani thoshte se ajo mund të gatuante për shkollën. Në fund të fundit, kot e kishte ndjekur Shkollën e Ekonomisë Shtëpiake ajo? Prifti thoshte, se Fani ishte gruaja më e kulturuar në fshat. Ajo nuk e dinte, nëse ai po tallej me të, por kur erdhi herën tjetër, ai kishte pyetur dhe tha, se kisha do ta mbështeste Fanin. Ai e quante atë të virtytshme dhe u ndie i fyer, kur Fani qeshi. Fani i raportoi të shoqit për këto plane. Meqë mësuesi nuk donte që prifti të mbahej me shpresa të tepërta, ai u kujdes, që Fanit t'i caktoheshin ushqime edhe nga partia për të gatuar për fëmijët e shkollës. Prifti mendonte se një libër i kuq partie nuk e kishte vendin aty në fshat. Fani tha se kjo nuk kishte rëndësi, për sa kohë fëmijët kishin për të ngrënë.

PRINDËRIT MORËN LAJM për vdekjen e vëllait. Gjysmë viti më parë, një burrë nga fshati fqinj ishte kthyer nga robëria dhe ata kishin shpresuar, se e kishte radhën Toni. Por tani e dinin se ai kishte rënë në luftë. “Rënë”, mendoi Fani, tingëllonte sikur ta kishte fajin ai për këtë. A thua se ai ishte dorëzuar, ashtu siç besonte Fani në çastet e saj të dobësisë, se do të dorëzohej dhe nuk do të duronte më. Ata kishin shpresuar se ai do të kthehej, babai dhe nëna kishin besuar dhe ishin lutur, por ai kishte vdekur tashmë. Fani i premtoi të atit, se do ta merrte ajo në dorë çifligun. Si fillim, do të ndihmonte prindërit gjatë punës dhe në një moment të caktuar mësuesi dhe ajo do të shpërnguleshin në lug dhe do të merrnin përsipër çifligun. Shpesh Fani shkonte kodrës përpjete e tatëpjetë disa herë në ditë. Ajo e kishte organizuar me përpikëri kohën, në mënyrë që, pasi të ishte përgatitur ushqimi në kuzhinën e shkollës, ajo të mund të ishte te prindërit për dy orë, përpara se fëmijët të uleshin për të ngrënë. Në pasdite vonë ajo vraponte edhe njëherë për në çiflig për të ndihmuar në ahur. Fani përpiquej të punonte në çiflig po aq sa para martesë. Mundohej të shfaqej aq natyrshëm, sa të dukej sikur nuk kishte ikur fare, sikur nuk ishte martuar dhe nuk ishte larguar nga çifligu i prindërve. Por çdoherë, kur mbërrinte në çiflig, babai ishte aty dhe thoshte: Ah, Fanushe. A thua se habitej që e shihte. A thua se nuk e priste. Këtë herë, Fani nuk donte t’i linte në baltë prindërit. Por që pas dy orësh, kur ndahej prej tyre pa

rënë në sy, a thua se do të shkonte shkurtimisht diku, ajo i braktiste sërish ata të dy, derisa herën tjetër të vinte prapë e përpiktë në kohë dhe babai të thoshte: Ah, Fanushe. Ajo e dinte, se i ati e vinte re çdoherë, që Fani kishte ardhur vetëm dhe mësuesi nuk e kishte shoqëruar, të ndihmonte edhe ai. Por nga njëra anë kjo ishte gjëja e duhur, se kështu babai mund të krijonte përshtypjen që asgjë nuk kishte ndryshuar. Babai e përmendte rrallë mësuesin, por herë pas here thoshte, se e kanë në racë ata që u duket vetja më të mirë se të tjerët, sepse edhe babai i burrit të Fanit, madje edhe e motra, ishin mësues. Pastaj mamaja ia kthente, pa e parë babanë në sy: Je i padrejtë me të. Të paktën ka luftuar, thoshte babai, dhe me këtë fjali e mbyllte bisedën. Në fshat tregonin se ai kishte dalë me një plagë goditjeje në qafë nga një prej avionëve të fundit të Stalingradit. Fani nuk kishte folur kurrë për këtë me të shoqin, por ishte e lumtur, që atij i kishte ndodhur diçka kaq e keqe, sepse ndiente, që babai e respektonte mësuesin për këtë.



NDONJËHERË, KUR KTHEHEJ NGA ÇIFLIGU, duke iu ngjitur kodrës, Fanin e kaplonte dobësia. Kur vraponte në malore, ndiente dobësi dhe vraponte me vrull për ta mposhur, por pikërisht në gjysmë të udhës, në pjesën ku rruga i ngjitej kodrës, për t'u drejtuar më pas e rrafshët drejt ndërtesës së shkollës, dobësia e mbërthente. E kapte në çastin, kur Fani hidhte hapin mbi bordurë. Siç donte dikur ta linte kokën të binte mbi tryezë, ashtu kishte tani ndjesinë, se do të fundosej përtokë. Rrinte mbi bordurë dhe luhatej, a thua se një çast më vonë do të rrëzohej dhe rrokullisej kodrës teposhtë. Ashtu si dikur koka e saj nuk kishte rënë, as tani Fani nuk rrëzohej kodrës tatëpjetë, megjithëse besonte, se tashmë ishte dorëzuar. Edhe sot kishte frikë se nuk do ta mbante dot veten, nëse do ta shihte dikush, dhe njëherësh përfytyronte, sesi do ta gjenin të shtrirë përtokë. Do të kishte dashur ta dinte, se ku do ta shpinin, sipër në ndërtesën e shkollës, apo poshtë në çifligun e lugut. Nëse vërtet vinte dikush, e përshëndeste Fanin dhe e thërriste në emër, ajo lëvizte dhe i kthente përshëndetjen. Thoshte, se sa po vinte nga prindërit dhe i duhej të kthehej në shkollë, e pastaj flisnin për motin, se së shpejti do të korrej e sistemohej sana. Fani thoshte mirupafshim e merrte drejtimin për në ndërtesën e shkollës. Ajo ishte mësuesja dhe kështu do të ishte përgjithmonë. Llogariti, se sa triska ushqimesh i mbeteshin ende dhe a do të mund ta ndihmonte prifti për të gjetur më shumë sheqer. Përshëndeti një punëtor pylli

në çifligun e baxhos së vjetër dhe ndjeu diellin t'i ngrohte lëkurën e krahëve. Fani eci përgjatë rrugës, pa u nxituar, sepse ishte e lumtur. Për një çast nuk po i interesonte fare, nëse dikush që do ta shihte, mund të mendonte, se ajo nuk kishte ç'të bënte.

MËSUESI ISHTE GJITHMONË NË DIJENI, se ku kishte aktivitete vallëzimi e shpesh Fani dhe ai merrnin makinën dhe bënëin rrugë një orë a më shumë për të vallëzuar diku gjithë mbrëmjen. Me kalimin e kohës Fani e kishte harruar lidhjen midis hapave e numërimit të bijës së gjykatësit dhe lëvizjet i ishin bërë më të rrjedhshme. Mësuesi i kishte mësuar hapa të rinj, vetëm duke e drejtuar në vallëzim. Ai thoshte, se sa i lumtur ishte që kishte të vetmen grua, në të gjithë zonën, e cila dinte të vallëzonte. Në fshat qeshnin me vallëzimet e çiftit të mësuesve, ndaj Fani donte më mirë të shkonte atje, ku nuk njihnin kënd. Pasi mësuesi i kishte blerë asaj një makinë qepëse, Fani qepte rroba, të cilat i vishte, vetëm kur shkonin në vendet më të largëta. Rrobat kishin funde me rrudha dhe ishin pa mëngë, vetëm me rripa të hollë mbi supe. Mbrëmjeve, kur shkonin të vallëzonin, Fani kujdesej, mos t'i shihte askush, kur dilnin nga ndërtesa e shkollës dhe hipnin në makinë. Vetëm pasi e kishin kaluar rrugën e pyllit dhe kishin marrë kthesën te rruga e madhe, ajo hiqte shallin dhe e vendoste në prehër. Ndërsa drejtonte makinën, mësuesi shihte me bisht të syrit supet e Fanit, të cilat, përveçse kishin ata rripat e hollë, ishin të zhveshura. Fani bënte, sikur nuk e vinte re, por ajo e dinte, se atij i pëlqenin shumë fustanet. Ndonjëherë ai i propozonte që ta shoqëronte, kur kishte diçka për të bërë në qytetin e vogël. Shkonin së bashku deri te dyqani i copave jo larg portës së qytetit. Kur Fani